



Prishtinë: 15 prill 2009  
Kodi i ZRRE-së: V\_173\_2009  
REF: D\_067\_2007 dhe V\_155\_2009

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke marrë parasysh:**

1. Dispozitat e neneve 15 dhe 26 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 28.7 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji.
3. Nenin 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhënë KEK Sh.a.
4. Kërkesën e KEK Sh.a për vazhdimin e vlefshmërisë së **Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike dhe vazhdimin e vlefshmërisë së Procedurës së përkohshme për faturimit dhe leximit të konsumatorëve shtëpiak.**

në seancën e mbajtur me 15. prill 2009 nxori këtë:

**VENDIM**

- I **I lejohet KEK SH.A. vazhdimi i vlefshmërisë së Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike** deri me aprovimin e ndryshimeve të së njëjtës, e më së largu deri me 30 qershor 2009.
- II **I lejohet KEK SH.A. vazhdimi i vlefshmërisë së Procedurës së përkohshme për faturimit dhe leximit të konsumatorëve shtëpiak** deri me aprovimin e ndryshimeve të së njëjtës, e më së largu deri me 30 qershor 2009.

**Arsyetim**

1. KEK SH.A, ka bërë kërkesë për aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në **Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike** në dhjetor 2008, ndërsa në janar 2009 ka bërë kërkesë për aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në **Procedurës së përkohshme për faturimit dhe leximit të konsumatorëve shtëpiak.**
2. ZRRE disa herë ka bërë komente në këto dokument, ndërsa KEK sh.a është në fazën përfundimtare të precizimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të këtyre dokumenteve, andaj mbetet që edhe më tutje të përpunohen dhe përmirësohen kështu që të arrihen te një draft i mirëfilltë për aprovim.
3. Duke pas parasysh se këtyre Procedurave iu ka skaduar vlefshmëria me 31 mars 2009 nga arsyet e cekura në pikën 2, dhe në mënyrë që mos të lejohet vakum ligjor, është vepruar si në dispozitiv të këtij vendimi.
4. Ky Vendim do të nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditëve nga data e aprovimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar